



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.2/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik " SLOŽNO POBEĐUJEMO ", me seli ne Leposaviq, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr. 01/795-2026 të datës 14.05.2026, lidhur me refuzimin për certifikim për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.05.2026, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik "SLOŽNO POBEĐUJEMO", me seli në Leposaviq, ZP.Anr.2/2026, e datës 15.05.2026, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr.01/795-2026, të datës 14.05.2026, lidhur me refuzimin për certifikim për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.2/2026, të datës 15.05.2026, nga subjekti politik " SLOŽNO POBEĐUJEMO ", me seli në Leposaviq, në të cilën theksohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 14.05.2026 ka marrë vendimin numër 01/795-2026, me të cilin refuzon konfirmimin e subjektit politik " SLOŽNO POBEĐUJEMO ", me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 2, paragrafi 7 i Rregullores Zgjedhore nr. 04/2024 për konfirmimin e subjekteve politike dhe të kandidatëve të tyre, për shkak se nga gjithsej 1087 nënshkrues, 576 prej tyre nuk kanë shënuar numrat e telefonit, dhe se të njëjtit konsiderohen të pavlefshëm sepse nuk janë të plotë; se rreth 80 të kontaktuarve të mbështetësve nuk kanë qasje në numra dhe se "disa" kanë deklaruar se nuk e kanë nënshkruar personalisht listën e mbështetësve. Parashtruesi i ankesës thekson se me datën 13.05.2026, përmes postës elektronike në orën 21:26, një zyrtar i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar ka njoftuar parashtruesin e ankesës që në një afat shumë të shkurtër, deri më 14.05.2026 në orën 14:00, të dorëzojë 600 nënshkrime shtesë, sepse nënshkrimeve u mungojnë numrat e telefonit, ose janë të pasakta ose nuk janë të qasshme. Brenda afatit të paraparë, parashtruesi ka arritur të dorëzojë 423 nënshkrime shtesë. Këtë e konstaton edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vendimin e tij. Sipas parashtruesit të ankesës mbledhja e 600 nënshkrimeve shtesë në një afat kaq të shkurtër prej vetëm disa orësh, në rrethanat në të cilat gjendet një komunitet relativisht i vogël serb, me presione të vazhdueshme nga subjektet e tjera politike që ekzistojnë në të, ishte një kërkesë e pamundur për t'u përmbushur. Afati prej gjithsej 16 orë e gjysmë, nga të cilat pothuajse gjysma gjatë natës, kur njerëzit flenë, ishte i paarsyeshëm dhe praktikisht i perealizueshëm, duke i vendosur fatin e pjesëmarrjes në

zgjedhje për subjektin politik "SLOŽNO POBEĐUJEMO" faktikisht para vendimit formal të KQZ-së. Subjektit politik i është dhënë një afat jo proporcional, në kundërshtim me parimet themelore të një procesi zgjedhor të ndershëm dhe demokratik, që brenda vetëm disa orësh duhej të organizonte aktivitetet në terren, të mbledhte nënshkrime të reja, t'i verifikonte dhe t'i dorëzonte nënshkrimet e korrigjuara. Është veçanërisht e rëndësishme se bëhet fjalë për një numër të madh nënshkrimesh që duheshin siguruar në një afat kohor të pamundur. KQZ-ja duhej të mundësonte një mundësi reale dhe efektive për eliminimin e mangësive, e jo vetëm formale e cila në praktikë ishte e porealizueshme. Theksojmë se afatet për korrigjim të përcaktuara në nenin 4 të Rregullores Zgjedhore NR. 04/2024 për konfirmimin e subjekteve politike dhe të kandidatëve të tyre janë dukshëm më të gjata se afati që na ishte lënë neve. Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se pas marrjes së email-it të përmendur, kërkuam përmes postës elektronike në orën 23:17, të së njëjtës mbrëmje, nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar zgjatjen e arsyeshme të afatit për dorëzimin e të dhënave të kërkuara dhe plotësimin e numrave të telefonit që mungojnë, por nuk kemi marrë përgjigje deri në paraqitjen e kësaj ankesë. Gjithashtu, theksojmë se 576 nënshkrime që nuk përmbajnë numra telefoni nuk duhet të ishin hedhur poshtë apriori. KQZ-ja i ka diskualifikuar faktikisht për shkak të një mangësie formale. Një qasje e tillë është në kundërshtim me thelbin e së drejtës zgjedhore. Numri i telefonit nuk përbën element të identitetit të zgjedhësit dhe nuk është kusht thelbësor për vlefshmërinë e nënshkrimit të mbështetjes. Për më tepër, kushtet formale-juridike shpesh nuk janë gjithmonë në përputhje me realitetin që na rrethon. Anëtarët e komunitetit serb jetojnë në frikë dhe nën presione të disa subjekteve të tjera politike që janë konfirmuar. Në atë atmosferë, disa nga nënshkruesit nuk kanë dashur as nuk kanë guxuar të japin numrat e tyre të telefonit, ashtu siç disa që janë përgjigjur kanë dhënë përgjigjet e përmendura në vendim, duke u frikësuar se po verifikohen nga subjektet e sipërpërmendura, të cilët mund t'u rrezikojnë ekzistencën për shkak të mbështetjes së opozitës, gjë që u ka ndodhur shumëve në të kaluarën dhe sot. Është fakt se një pjesë e këtyre nënshkruesve nuk kanë fare numra telefoni sepse nuk përdorin telefon, ashtu siç një pjesë e tyre kanë numra në rrjetet e Republikës së Serbisë dhe se sigurisht që kjo ishte një mangësi e eliminueshme nëse do të kishte kohë shtesë për korrigjimin e saj, ndërsa hedhja e tyre e tillë poshtë kufizon të drejtën pasive zgjedhore të subjektit politik, por edhe të drejtën aktive zgjedhore të qytetarëve që kanë dhënë mbështetjen e tyre. Andaj të njëjtit i propozojnë që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia të nxjerrë vendim me të cilin shfuqizohet vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.01/795-2006 të datës 14.05.2026, dhe detyrohet Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar që t'i lërë një afat të përshtatshëm subjektit politik " SLOŽNO POBEĐUJEMO " për dorëzimin e nënshkrimeve shtesë dhe korrigjimin e të dhënave të paplota, ose t'i pranojë si të vlefshme nënshkrimet të cilat mungon numri i telefonit dhe të certifikojë subjektin politik " SLOŽNO POBEĐUJEMO ".

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se Periudha e aplikimit për certifikimin e subjekteve politike për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat mbahen më 07.06.2026, ka filluar më 2 maj 2026 dhe ka përfunduar më 10 maj 2026 në orën 24:00. Duke pasur parasysh që procesi zgjedhor i jashtëzakonshëm realizohet me afate të shkurtuara, afati për certifikim sipas Planit Operacional ka qanë i hapur për nëntë (9) ditë. Duke qenë se afati ka përfunduar me 10 Maj në ora 24:00, Zyra ka filluar verifikimin e aplikimeve për certifikimin menjëherë me datën 11 maj 2026. Për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2026, një (1) Iniciativa qytetare ka aplikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, iniciativa qytetare SLOZNO POBEĐUJEMO e cila ka dorëzuar dokumentet si në vijim: Listën e mbështetësve, të cilët janë verifikuar me versionin e fundit të listës së votuesve; taksën e certifikimit; logon, kodin e mirësjelljes dhe deklaratën politike. Sipas paragrafit 7 të nenit 2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, subjektet politike që aplikojnë për certifikim, obligohen ta dorëzojnë listën e mbështetësve me së paku një mijë (1,000) nënshkrime. Të gjitha subjektet politike kanë qenë të obliguar ta plotësojnë listën (librezën) e nënshkrimeve të mbështetësve,

e cila përmban: Emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, adresën e banimit, numrin e telefonit, numrin personal të identifikimit dhe nënshkrimin. Si pjesë e shqyrtimit të aplikimit për certifikim, Zyra e rishikon secilën broshurë me nënshkrime të dorëzuar në mbështetje të aplikimit për certifikim për të siguruar se nënshkrimet janë të vlefshme. Llojet e nënshkrimeve në vijim konsiderohen si të pavlefshme dhe nuk llogariten ndaj kërkesës së nënshkrimeve: nënshkrimet e personave të cilët nuk janë votues të regjistruar; nënshkrimet e mbështetjes për të cilat çfarëdo informate e kërkuar mungon apo është e pa lexueshme; nënshkrimet të cilat janë me të njëjtin dorëshkrim si nënshkrimet tjera, përfshirë nënshkrimet nga udhëheqësi i familjes për anëtarët e tjerë të familjes dhe nënshkrimet të cilat përfshijnë informata të cilat nuk përputhen me informatat e regjistruara në variantin më të fundit të listës së votuesve. Platforma elektronike për aplikim për certifikim në mënyrë automatike verifikon çdo mbështetës të futur në platformë duke e krahasuar me ekstraktin e listës votuese. Cilido mbështetës që nuk gjendet në listën votuese refuzohet nga platforma, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin që secili mbështetës të jetë votues i regjistruar në Republikën e Kosovës Zyra kontrollon secilën broshurë të nënshkrimeve për të vetëtuar që fillimisht është dorëzuar numri i duhur i nënshkrimeve. Më tutje verifikimet bëhen për të kontrolluar nëse nënshkrimet e dorëzuara janë valide sipas kërkesave ligjore. Këto verifikime bëhen duke kontrolluar nëse janë përfshirë të gjitha informatat e kërkuara në broshurën e nënshkrimeve. Më tutje Zyra kontakton me mbështetësit për të verifikuar nëse ata kanë dhënë nënshkrimet e tyre personalisht dhe se janë informuar nga mbledhësi i nënshkrimeve për arsyen e mbledhjes së nënshkrimeve. Ky subjekt politik ka dorëzuar listën e mbështetësve me gjithsejtë 1,087 nënshkrime. Siç u theksua më lartë, verifikimi i aplikimit për certifikim ka filluar menjëherë me datën 11 maj dhe Zyra menjëherë ka vërejtur që në broshurën e nënshkrimeve të përkrahjes të subjektit politik SLOZNO POBEĐUJEMO, një numër i konsiderueshëm i nënshkruesve nuk kanë ofruar numrin e kontaktit gjë që pamundëson Zyrën të bëjë verifikimin e nënshkruesve duke i kontaktuar. Po të njëjtën ditë, më 11 Maj, Zyra ka komunikuar me përfaqësuesit e iniciativës duke i treguar për mungesën e të dhënave në broshurën e nënshkrimeve të mbështetësve dhe ka hapur platformën e aplikimit përsëri për iniciativën politike në fjalë për të mundësuar përmirësimin e informatave që kanë munguar në broshurën e nënshkrimeve. Iniciativa politike ka bërë përmirësimin e një numri të pjesshëm të informatave të kërkuara mirëpo edhe pas përmirësimit një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve të përkrahjes, ka vazhduar të mungojë numri i kontaktit. Në përputhje me kërkesat ligjore që dalin nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, më saktësisht neni 23, Zyra ka verifikuar nënshkrimet e mbështetjes për certifikimin e subjektit politik SLOŽNO POBEĐUJEMO dhe si rezultat 1,015 nënshkrime janë validuar në platformë dhe konfirmohet se janë votues në listën preliminare të votuesve; disa nënshkrues/ mbështetës që janë kontaktuar, kanë deklaruar se nuk janë nënshkruar personalisht në listën e mbështetësve; rreth 80 persona që janë kontaktuar përmes telefonit në datat 12 dhe 13 maj 2026, nuk kanë qasje në numrat e dhënë; nga 1,087 nënshkrues gjithsejtë, 576 nënshkrues nuk kanë dhënë numra të telefonit, siç kërkohet me listën e mbështetësve. Zyra me datën 13.05.2026 i ka dërguar e-mail Iniciativës me kërkesën për dërgim të nënshkrimeve shtesë (600 nënshkrime) duke i dhënë afat për dorëzim deri me datën 14.05.2026, në orën 14:00. Iniciativa politike ka dorëzuar formën fizike të broshurës së nënshkrimeve të mbështetësve në ora 14:50 dhe në 15:11 ka dorëzuar formën elektronike të kërkuar. Dokumentacioni shtesë është dorëzuar pas afatit të dhënë deri në ora 14:00 dhe janë dorëzuar vetëm 423 nënshkrime prej 600 të kërkuara. Afatet e shkurtuara janë si rezultat i procesit të jashtëzakonshëm zgjedhor. Afatet për secilin aktivitet përcaktohen menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve përmes Planit Operacional të aprovuar nga KQZ. Siç u theksua më lartë, subjektet politike kanë pasur nëntë ditë për të aplikuar, nga 2 deri më 10 Maj 2026. Gjatë kësaj kohe subjekti politik ka mbledhur nënshkrimet e përkrahjes me formularin e përcaktuar me Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre ku përcaktohet qartë çfarë të dhëna duhet të mblidhen nga mbështetësit e procesit të certifikimit për subjektin politik në fjalë. Pavarësisht afateve të shkurtra, Zyra ka vërejtur që subjekti në fjalë ka mungesë informatash

ne broshurën c nënshkrimeve të përkrahjes dhe ka hapur platformën e certifikimit me qëllim që të ofrohet mundësia për të përmirësuar listën c nënshkrimeve me të dhënat e kërkuara, me ç ‘rast subjekti politik është përgjigjur duke plotësuar këto dhëna pjesërisht. Përsëri Zyra ka bërë verifikimin e plotë të Listës së nënshkrimeve pas plotësimeve të bëra dhe ka vërejtur se ka mungesa serioze të cilat janë shpjeguar më lartë, dhe i është dhënë përsëri afat shtesë subjektit politik për të mbledhur nënshkrime shtesë brenda afatit të dhënë. Subjekti politik ka dështuar të respektojë afatin e dhënë si dhe nuk ka dorëzuar numrin e kërkuar të nënshkrimeve. Afati i certifikimit lidhet ngushtë me aktivitetet e tjera të procesit 7 zgjedhor të cilat janë qenësore për këtë proces. Me datën 16 Maj 2026 sipas Planit Operacional duhet të organizohet shorti i tërheqjes së numrave të subjekteve politike që do të marrin pjesë në Zgjedhje të cilat përcaktojnë përmbajtjen dhe dizajnin e fletëvotimit i cili është i domosdoshëm për fillimin e votimit përmes postës. Çfarëdo shtyrje e afatit të certifikimit do të rrezikonte një varg të aktiviteteve kyçe të procesit zgjedhor. Nisur nga sa u tha më lartë, Zyra ka rekomanduar KQZ për refuzimin c aplikimit për certifikim të subjektit politik SLOŽNO POBEDUJEMO, siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 17 të LZP. Rekomandimi i Zyrës është aprovuar nga KQZ në takimin nr. 47 të datës 14 Maj 2026 dhe është marrë vendimi 01/795-2026 për refuzimin e certifikimit të subjektit politik SLOŽNO POBEDUJEMO. Si dëshmi kane bashkangjitur vendimin e ICQZ 01/795-2026 për refuzimin e certifikimit të subjektit politik SLOŽNO POBEDUJEMO, dosjen e plotë të aplikimit për certifikim të subjektit politik SLOŽNO POBEDUJEMO.

PZAP-i, pasi bëri vlerësimin e ankesës provave të bashkangjitura të njëjtës dhe përgjigjes në ankesë së bashku me prova, vëren se ankesa e ankuesit është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerëson se pretendimet e palës ankuese janë të pabazuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesi i ankesës në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar ka dorëzuar listën e mbështetësve me gjithsejtë 1,087 nënshkrime, ndërsa kjo zyre nga verifikimet e bëra lidhur me aplikimin për certifikim ka vërejtur që në broshurën e nënshkrimeve të përkrahjes të subjektit politik SLOZNO POBEDUJEMO, një numër i konsiderueshëm i nënshkruesve nuk kanë ofruar numrin e kontaktit gjë që i ka pamundësuar Zyrës të bëjë verifikimin e nënshkruesve, dhe përkundër që të njëjtës i është dhënë mundësia që të bëjë përmirësimet e kërkuara Iniciativa politike ka bërë përmirësimin e një numri të pjesshëm të informatave të kërkuara mirëpo edhe pas përmirësimit një numër i konsiderueshëm i nënshkrimeve të përkrahjes, ka vazhduar ti mungojë numri i kontaktit, ku nga 1,015 nënshkrime të cilat janë validuar në platformë dhe konfirmohet se janë votues në listën preliminare të votuesve disa nënshkrues-mbështetës që janë kontaktuar, kanë deklaruar se nuk janë nënshkruar personalisht në listën e mbështetësve, pastaj rreth 80 persona që janë kontaktuar përmes telefonit në datat 12 dhe 13 maj 2026, nuk kanë qasje në numrat e dhënë, nga 1,087 nënshkrues gjithsejtë, 576 nënshkrues nuk kanë dhënë numra të telefonit, siç kërkohet me listën e mbështetësve. Përkundër kësaj Zyra me datën 13.05.2026 i kishte dërguar e-mail Iniciativës me kërkesën për dërgim të nënshkrimeve shtesë të 600 nënshkrime duke i dhënë afat për dorëzim deri me datën 14.05.2026, në orën 14:00. Iniciativa politike ka dorëzuar formën fizike të broshurës së nënshkrimeve të mbështetësve në ora 14:50 dhe në 15:11 ka dorëzuar formën elektronike të kërkuar. Dokumentacioni shtesë është dorëzuar pas afatit të dhënë deri në ora 14:00 dhe janë dorëzuar vetëm 423 nënshkrime prej 600 të kërkuara.

Me nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është përcaktuar se *“Si pjesë e shqyrtimit sipas nenit 17 paragrafi 1 të këtij ligji, Zyra e rishikon secilën broshurë me nënshkrime të dorëzuar në mbështetje të aplikimit për certifikim për të siguruar se nënshkrimet janë të vlefshme”*. Ndërsa në nenin 23 paragrafi 2 të të njëjtës rregullore përcaktohet se *“Në vërtetimin e nënshkrimeve të mbështetjes, Zyra e rishikon secilën broshurë të nënshkrimeve të dorëzuar nga aplikuesit siç përcaktohet me*

rregullat e KQZ-së.”. Kurse me nenin 2 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1, dhe 7.2 të Rregullores Zgjedhore nr.04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, është përcaktuar se “Subjektet politike, në aplikimin për certifikim, duhet të përfshijë librezat e nënshkrimeve, në formularin i cili është bashkëngjitur, në formë fizike dhe elektronike, Shtojca II – Libreza e nënshkrimeve (në formën fizike dhe elektronike), që përmban: 7.1. njëqind (100) nënshkrime të vlefshme të përkrahjes së votuesve të regjistruar për secilën komunë në të cilën subjekti politik ka për qëllim të garojë. Në rast se ka për qëllim që të garojë në dhjetë ose më shumë komuna, atëherë numri i nënshkrimeve duhet të jetë të paktën njëmijë (1,000) nënshkrime. 7.2. njëmijë (1,000) nënshkrime të vlefshme, nëse ka për qëllim të garojë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës”. Ndërsa në nenin 4 nën paragrafi 2 të tenjëjtës rregullore është përcaktuar se “2.2 dokumentacioni përcjellës është i plotë dhe se nënshkrimet në librezën e nënshkrimeve janë të vlefshme dhe të njaftueshme”.

Mbi këtë bazë ligjore dhe provave të cilat gjinden në ankesë dhe përgjigje në ankesë, Paneli vlerëson se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit drejtë ka zbatuar dispozitat e sipërcituara ligjore dhe nënligjore, pasi që subjekti politik SLOŽNO POBEĐUJEMO nuk i ka përmbushur kriteret e kërkuara sipas dhe paragrafit 7 të nenit 2 të dhe nenit 4 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, ku subjektet politike që aplikojnë për certifikim, është edhe kriteri të dorëzojnë listën e mbështetësve me së paku njëmijë (1,000) nënshkrime.

Andaj, Paneli vlerësoj edhe pretendimet e ankuesit nga ankesa, “... se para vendimit formal të KQZ-së Subjektit politik i është dhënë një afat jopropocional, në kundërshtim me parimet themelore të një procesi zgjedhor të ndershëm dhe demokratik, që brenda disa orësh duhej të organizonte aktivitetin në terren, të mblidhte nënshkrime të reja, t'i verifikonte dhe t'i dorëzonte nënshkrimet e korrigjuara...” Mirëpo të njëjtat i vlerëson si të pa qëndrueshme, për faktin se ankuesja ka qenë e njoftuar publikisht që nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve, se kemi të bëjmë më zgjedhje të parakohshme dhe se afatet për kryerjen e secilit veprim në drejtim të plotësimit të kriterëve ligjore për pjesëmarrje në zgjedhje është shumë më i shkurtër se në zgjedhjet e rregullta dhe në këtë kuptim të njëjtat pretendime i refuzoj si të pabazuara.

Mbi këtë bazë, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 3, “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Prandaj, nga arsyet e parashtruara më lart dhe në pajtim me nenin 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 2, dhe neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, të Rregullores, së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZP.Anr.2/2026 më datën 16.05.2026



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.